



# REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

## KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës,  
Kuvendi i Komunës së Junikut,  
Numër: 02/06,  
Datë: 28.03.2014 .

|                                                                    |          |            |
|--------------------------------------------------------------------|----------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA<br>Komuna Junik-Opština Junik |          |            |
| 02/Nr.Port.                                                        | Nr.i faq | Data       |
| 2-004-2419                                                         | 2        | 31.03.2014 |

Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d) i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008 ); nenit 10 paragrafi b); nenit 22 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe nenit 3 paragrafi 2 i Udhëzimi Administrativ Nr. 27/2017 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 28.03.2014, nxjerrë:

### V E N D I M

për themelimin e

#### Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

I. Me këtë vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në komunën e Junikut/në tekstin e mëtejme këshilli/ .

II. Këshilli ka këtë përbërje: (neni 4 i U/A Nr. 27/2017 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së).

1. kryetari i komunës së Junikut,
2. komandanti i stacionit të policisë në Junik,
3. një përfaqësues i bashkësisë islame,
4. kryesuesi i Komitetit për Komunitete,
5. zyrtari/ja për barazi gjinore,
6. drejtori i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sporte,
7. kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të komunës së Junikut,
8. një përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës,
9. një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike,
10. kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,
11. një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale,
12. përfaqësuesi/ja i/e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe
13. një përfaqësues nga OJQ-të,
14. një përfaqësues nga mediet lokale,
15. një përfaqësues nga komuniteti i biznesit, dhe
16. një përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

III. Detyrat dhe përgjegjësitë e këshillit janë të rregulluara me nenin 6 të U/A Nr. 27/2017 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së.

IV. Kryesuesi i këshillit është kryetari i komunës së Junikut (neni 8 i U/A Nr. 27/2017 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së).

**V.** Kryetari i komunës së Junikut ka për detyrë që me shkrim t'iu drejtohet subjekteve nga pika II. e këtij vendimi për delegimin e përfaqësuesve të tyre në këshill.

**VI.** Lista e këshillit me emra konkret të propozuar nga subjektet nga pika II. e këtij vendimi duhet t'i dërgohet kuvendit të komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

**VII.** Këshilli harton planin vjetor të punës dhe ia prezanton kuvendit të komunës së Junikut për miratim më së largu 30 ditë nga konstituimi i tij.

**VIII.** Këshilli ka për detyrë që për aktivitetet e tij brenda vitit kalendarik ta njoftojë 2 herë kuvendin e komunës së Junikut.

**IX.** Anëtarët e këshillit kanë mandat të njëjtë me anëtarët e kuvendit të komunës së Junikut.

**X.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo çështje ka qenë e rregulluar.

**XI.** Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. MAPL - MPB,
2. anëtarët e këshillit, dhe
3. arkivi i komunës së Junikut.



Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

*Faik Tofa*  
kryesues

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://kk.rks-gov.net/junik>